



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:013518

Datë: 02.11.2018

Numri i dokumentit: 00160304

P. nr. 819/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.J. nga fsh. Sh. K Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP/II.nr.1487/17 të datës 27.11.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë **31.10.2018**, në prani të prokurorit të shtetit Xhavit Osmani, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. E. B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.J.**, nga fsh. Sh. K Gj., data e lindjes... ne Gj., i biri i Gj. dhe i nënës Sh. e gjinisë G., ka të kryer shkollim universitar, mjekë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, atë i 2fëmijëve, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- me dt. 28.07.2017, rreth orës 16.30, Rruga “Xh.H.” ne Gj.ë, saktësisht afër mobilshop” A.”, i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të dëmtuarit A. B.i, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në veturë me vajzën e hallës së tij D., ndërsa i pandehuri ishte veturën e tij, në momentin kur veturat janë bere paralel që të shmangen aksidentit, i dyshuari dhe i dëmtuari nga veturat ja kanë ngritur dorën njeri tjetrit, i pandehuri i revoltuar del nga vetura e tij shkon te vetura e të dëmtuarit pasi ia hap derën e sulmon duke e goditur me grushte dhe shkelma në fytyrë dhe hundë deri është larguar nga kalimtarët e rastit, me ç’ rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat lëndime me gjerësisht janë të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko –ligjor ete dt. 22.10.2017 nga eksperti mjeko –ligjor Dr. F.D.

-me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1-1.4 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188/1-1.4 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimi, në afatin prej 1(një) viti të mos kryen veprë tjetër penale.

I dëmtuari A.B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil .

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, shpenzimet procedurale dhe atë në emër të ekspertizës mjekësore **20,00.-€**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e kërjt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1487/17 të dt.27.11.2017, ka akuzuar të akuzuarin A. J. nga fshati Sh., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 31.10.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Xhavit Osmani, PP/II.nr.1487/17 dt. 27.11.2017 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës. I propozoi gjykatës që pas administrimit të provave të njëjtin ta shpallë fajtor ,ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në pagesën e shpenzimeve procedurale. Në fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga i akuzuari e që u bë i lirshëm e i vullnetshëm duke i kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lëndës ka edhe prova tjera bindëse se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-1.4 të KPRK-ës , e gjykatës i propozoi që të njëjtin ta shpall fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale të ta dënoj sipas ligjit dhe ta detyroi në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

I akuzuari A. J., në shqyrtimin gjyqësor duke duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksojë se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij në këtë fazë të procedurës deklaroi se e pranonte në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. E. B.deklaroi se fillimisht duke u konsultuar paraprakisht me të mbrojturin tim erdhëm të përfundimi se duhet të pranohet vepra e ngarkuar penale në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor ,andaj kërkojë nga prokurori i çështjes që të jep pëlqimin lidhur me këtë pranim të fajësisë dhe pas dhënies se atij pëlqimi gjykatës i propozoi që të merr aktvendim mbi pranimin e fajësisë. Në fjalën përfundimtare deklaroi se në sikurse edhe konstatoi gjykata me vullnetin e plotë e pranuar fajësinë se bashku me të mbrojturin tim. Mirëpo gjykata duhet të këtë parasysh me rrasitin e shqiptimit të dënimit dhe llojit të tij këto rrethana lehtësuese, pa durueshmëria paraprake ,pranimin e vullnetshëm të fajësisë , pendimi i thellë për veprën e ngarkuar penale në afekt ,premtimi se në të ardhme do të jete me i kujdesshme dhe nuk do të kryej vepra të tilla .

I akuzuari A. J. ,ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi faljen përfundimtare te mbrojtësi te tij ,shtojë se kërkojë falje nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara në afekt .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Gjykata ka konstatuar se me veprimet e te akuzuarit ekzistojnë te gjitha elementet e veprës penale te parapara nga neni 188/1-1.4 te KPRK-ës .

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsëris një veprim të tillë si dhe fakti se i njëjti më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Andaj ,Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit dënimit me burgim ne kohëzgjatje **prej 2 (dy) muajve**, me kusht që në afatin **prej 1(një) viti** të mos kryejë vepër tjetër penale, është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, peshën e veprës penale, me bindjen e plote se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 te KPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u murr komfor nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të shpenzimeve procedurale në shumë prej 20,00 € , në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.819/17 më datë 31.10.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.